



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III
Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi
Mbledhja nr. 01
Prishtinë, më 18 janar 2010, në orën 13:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N - 225

PROCESVERBAL
I mbledhjes së Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi

Morën pjesë: Bahri Hyseni - kryetar, Bajram Kosumi, Adem Hajdaraj, Selvije Halimi, Ramadan Gashi, Ibrahim Makoll, Adem Salihaj, Vladimir Todoroviq, Mufera Şinik dhe Kolë Berisha.

Mungoi: Armend Zemaj – ishte në udhëtim zyrtar.

Të pranishëm: Rrezarta Ahmeti – KDI, Blendi Gashi - Bota sot, Lumnije Murati - ZPRK, Vlora Marmullakaj – EULEX, Rinor Beka – NDI, Lejla Selimi – OSBE, Bedri Bahtiri - MD dhe Visar Krasniqi – Zyra e Komisioneve të Kuvendit.

Nga Staf i Komisionit: Idriz Tahiri, Fehmi Hyseni dhe Sulltane Gashi.

Mbledhjen e kryesoi: Bahri Hyseni, kryetar i Komisionit

R e n d i i d i t ë s

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të 7 dhe 14 dhjetor 2009,
3. Shqyrtimi i Propozimvendimit të Ministrisë së Drejtësisë për plotësimin dhe ndryshimin e Komisionit për dhënien e provimit të jurisprudencës,
4. Shqyrtimi i Propozimamendamenteve në Projektligjin për hetim parlamentar,
5. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për mjekësinë ligjore,
6. Të ndryshme.

Kryetari, konstatoi se ishin plotësuar kushtet dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

Miratimi i rendit të ditës

Rendi ditës u miratua pa ndryshime.

Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të 7 dhe 14 dhjetor 2009

Procesverbalet u miratuan pa vërejtje.

Shqyrtimi i Propozimvendimit të Ministrisë së Drejtësisë për plotësimin dhe ndryshimin e Komisionit për dhënien e provimit të jurisprudencës

Ibrahim Makolli - Propozoi që shqyrtimi i Propozimvendimit për provim të jurisprudencës të Ministrisë së Drejtësisë të hiqet nga rendi i ditës në mënyrë që të sqarohet pozicioni i Komisionit lidhur me këto propozime. Kuvendi akuzohet nga Ministria e Drejtësisë, e që do të duhej të ishte e kundërta, sepse Ministria i jep llogari Kuvendit.

Prandaj ju, si kryetar i Komisionit, duhet ta sqaroni pozicionin e Komisionit, sepse nuk është e vërtetë që Komisioni për Legjislacion e ka zvarritur këtë çështje.

Adem Salihaj - Tha se jam befasuar që disa herë me radhë kemi të njëjtin kandidat të propozuar dhe, si duket, tërë mandatin do të merremi me këtë çështje. Në vazhdim tha se në opinion po krijohet përshtypja se Komisioni është ai që po e bllokoi punën. E mbështeti propozimin që kjo pikë të mos shqyrtohet sot. Ndoshta do të duhej të kërkohej nga Kuvendi që të kërkojë një lloj përgjegjësie për ministren lidhur me kompletimin e Komisionit për formimin e provimit të jurisprudencës. Ne e dimë që kandidati Ruzhdi Berisha ka përvojë pune, mirëpo duhet të ketë 10 vjet pa ndërprerë si gjyqtar i lëndës, kështu e kërkon Ligji.

Adem Hajdaraj - Duke u ndërlidhur me parafolësit tha se çdo përpjekje për ta zvarritur këtë çështje jep të kuptojmë se kemi të bëjmë me subjektivizëm. Prandaj ka ardhur koha ose ta refuzojmë përfundimisht ose ta pranojmë për hir të atyre studenteve të cilët presin të hyjnë në këtë provim.

Kryetari - Është e vërtetë se jemi duke u marrë që dy vjet me këtë çështje, por kjo nuk ka ndodhur për shkak të dëshirës sonë ose neglizhencës sonë, sepse ne nuk jemi propozues. Përgjegjësi duhet të mbajnë ata që nuk e respektojnë vendimin e Kuvendit të Kosovës. Sepse ne, si Komisionit, tri herë e kemi dërguar për Kuvend dhe tri herë Kuvendi nuk i ka miratuar propozimet. Në vazhdim tha se do të ishte mirë që ne ta procedojmë për Kuvend dhe aty le të vendoset. Ne, si Komision, e kemi kryer punën tonë. Unë konsideroi se duhet t'i përcjellim për Kuvend propozimet dhe në rekomandim të theksohen shqetësimet, sikur herëve të tjera, për kandidatin Ruzhdi Berisha dhe Kuvendi le të vendosë, për hir të atyre kandidateve që presin t' i nënshtrohen këtij provimi.

Selvije Halimi - Në fjalën e saj tha se Ministria e Drejtësisë do të duhej të ishte shembull për drejtësi. Është fatkeqësi që Kosova ka mbetur në një emër që nuk mund të zëvendësohet. Kjo të bënë të mendosh që vërtet kemi të bëjmë me subjektivizëm, në fund të fundit nuk mund t'i thuash ndryshe. Ligji kërkon një kriter dhe ne, si Komision, e kemi konstatuar që nuk plotësohet. Nëse këto propozime i dërgojmë për Kuvend për hir të gjeneratës së re dhe t'i votojmë, nuk e di a do t'i japim shembull të mirë kësaj gjenerate, kur ne kemi dërguar në Komision njerëz që nuk i plotësojnë kushtet ligjore.

Bajram Kosumi - Tha se ne nuk mund t'i rekomandojmë Kuvendit për derisa s'e kemi një vendim në fuqi; së pari do të duhej të kërkojmë që ta shfuqizojmë atë vendim. Kjo çështje duhet sqaruar mirë dhe nuk mund të kalojë shpejt kjo çështje, sepse është stopuar një kohë. Nëse ministria nuk ka të drejtë atëherë kjo punë duhet thënë hapur, Por në këtë fazë nuk mund t'i mbyllim sytë dhe t'i propozojmë Kuvendit dhe ai të vendosë, sepse kemi një vendim në fuqi. Ne kemi thënë disa herë se kandidati Ruzhdi Berisha nuk i plotëson kushtet ligjore.

Ibrahim Makolli - Në fjalën e tij të sërishme tha se që dy vjet është bllokuar kjo çështje. Ne nuk jemi fajtor, fajtor është Ministria e Drejtësisë, e cila po përpiqet ta detyrojë Kuvendin ta shkelë ligjin. Nëse njëherë kandidati nuk votohet nga Kuvendi, ai vendim duhet respektuar. Nëse dikush po e vonon me qëllim dhe kanë interes të mos ketë juristë të rinj, janë pikërisht ata që po e mbajnë peng sistemin e drejtësisë.

Adem Salihaj - Tha se nëse ne rekomandojmë dhe e bindemi Kuvendin që ta votojë kandidatin, i cili nuk i plotëson kushtet ligjore të jetë anëtar i Komisionit dhe në këtë provim hyjnë studentët në një Komision që nuk është ligjor, nuk e di sa do të jenë ligjore provimet e dhëna para këtij Komisioni?

Adem Hajdaraj - Kërkoj sqarim pse nuk mund të mbahet provimi i jurisprudencës nëse i dërgojmë vetëm dy kandidatët e propozuar dhe kandidati Ruzhdi Berisha të mos propozohet. Pyeti se cila është pengesa që ky provim të mos mund të mbahet, nëse nuk kalon një kandidat?

Pas një diskutimi që u zhvillua dhe me propozimet e dala, ishte mendim i përgjithshëm që kjo pikë të shtyhet për mbledhjen e radhës dhe të shikohet mundësia në gjetjen e një zgjidhjeje eventuale.

Shqyrtimi i Propozimamendamenteve në Projektligjin për hetim parlamentar

Kryetari - Paraqiti për miratim Propozimamandamentet në Projektligjin për hetim parlamentar. E ftoi Ibrahim Makollin që në emër të grupit të punës të paraqesë arsyetimet për Propozimamandamentet.

Ibrahim Makolli - Tha se vërejtje përmbajtësore nuk ka pasur, diskutabile për grupin e punës ka qenë neni 5.1, prandaj ka mbetur të diskutohet në Komision.

U miratuan Propozimamandamentet 2,3,6,7,8,9,10, neni 23.7, ndërsa Komisioni diskutoi lidhur me nenin 5.1 dhe riformuloi: “*Kuvendi vendos për pushimin e punës së Komisionit para përfundimit të mandatit të tij me kërkesën e propozuesit dhe me shumicën e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit*”.

Shqyrtimi në parim i Projektligjit për mjekësinë ligjore

Komisioni e shqyrtoi në parim Projektligjin për Mjekësinë ligjore dhe pasi nuk pati vërejtje i njëjti procedohet për shqyrtim të mëtejshëm.

Të ndryshme.

Lidhur me këtë pikë nuk pati diskutime.

E hartoi:

Stafi Mbështetës i Komisionit.

Kryetari i Komisionit

Bahri Hyseni